



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtrresa-Kancelarija za Pradloga i Prastavke-Table Office

Nr. Prot. Br. Prot. No. *ps/1130/10-655*
Date Datum: *16.07.2015*
No. pages: *16.07.2015*

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

| | | | |
|---|---|--------------------------------|-------------------|
| PËR / ZA / TO | <i>Ministrin e Diasporës z. Valon Murati</i> | DATE DATUM DATE | 17.07.2015 |
| NGA / OD / FROM | <i>Deputetja: Salihe Mustafa</i> <i>Salihe</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Që prej 01 korrikut 2015, me vendim të BQK-së, kemi zbritje të tarifave për polisat e sigurimit të automjeteve me të cilat udhëtojnë bashkatdhetarët tonë për në Kosovë. Pyetja ime është:

PYETJE :

I nderuari z.Ministër:

Cili është reagimi i bashkatdhetarëve tonë rreth këtij vendimi të BQK-së për përgjysmimin e çmimit të tarifave për polisat e sigurimit të automjeteve?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



Për: z.Skender Hyseni, Ministër i Punëve të Brendshme
Nga: z. Slavko Simić, deputet i Grupit LS
Data: 21 korrik 2015
Lënda: Pyetje parlamentare

Bazuar në pikën 45.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, parashtror pyetje parlamentare për të marrë përgjigje gojore nga Ministri.

Gjatë pesë muajve të parë të këtij viti janë regjistruar rreth 180 sulme të motivuara etnikisht, veçanërisht në komunat e Pejës dhe Klinës. Jemi dëshmitarë se në muajt e fundit, veçanërisht dy javët e fundit, është rritur numri i incidenteve ndaj komunitetit serb.

Për shembull:

- Në Gorazhdevc- kanë ndodhur disa incidente, duke përfshirë sulmin ndaj automjetit me targa BG, si dhe zjarrëvënja në përmendoren e fëmijëve të vrarë në vitin 2003, në përmendore është shkruar grafiti me mbishkrim "hakmarrja".
- Në Klinë - pothuajse çdo ditë ndodhin vjedhje ndaj serbëve të kthyer, si dhe sulme verbale ndaj tyre.
- Në Kishnicë, Komuna e Graçanicës - gjatë një jave tri herë është gjuajtur me gurë prona e familjes Krstić. Këto janë disa shembuj të incidenteve të ndodhur vetëm në këtë vit.


Këto sulme ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë nuk mund të trajtohen si raste të izoluara, por institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin masa serioze për ofrimin e sigurisë për komunitetin serb në tërësi, veçanërisht për të kthyerit.

Pyetja ime për ministrin Hyseni është:

Si ka ndodhur rritja e dhunës ndaj popullatës serbe në Kosovë dhe çka janë duke ndërmarrë strukturat e sigurisë për arrestimin e personave përgjegjës për këto vepra penale.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



| | | | |
|---|---|--------------------------------|------------|
| PËR / ZA / TO | Z. Blerand Stavileci Ministër i Zhvillimit Ekonomik | DATE DATUM DATE | 21.07.2015 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Visar Ymeri, deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! <i>[Signature]</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Rindërtimi apo dekomisionimi i TC Kosova A vazhdon të mbetet temë aktuale. Situata energjetike në vend as për së afërmi nuk na e krijon komoditetin që ta neglizhojmë këtë çështje. Dekomisionimi i Kosovës A do ta thellonte tutje krizën energjetike dhe varësinë nga eksporti.

Kompania gjermane Bilfinger ka kohë që ka paraqitur një propozim për rindërtimin e TC Kosova A. Ky propozim do t'ia ngriste ndjeshëm kapacitetet gjeneruese KEK-ut dhe po aq me rëndësi do ta mbante këtë tërësisht në pronësi publike.

PYETJE PARLAMENTARE

Z. Ministër a do ta rindërtojme TEC Kosova A, apo do ta dekomisionojme atë?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



| | | | |
|---|--|--------------------------------|------------|
| PËR / ZA / TO | Z. Blerand Stavileci Ministër i Zhvillimit Ekonomik | DATE DATUM DATE | 21.07.2015 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Visar Ymeri, deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Në një intervistë dhënë të përditshmes ZËRI më 24 qershor të këtij viti, zv. Presidenti i Contour Global, ofertuesit të vetëm në tenderin për ndërtimin e TEC “Kosova e Re”, deklaroi se për sa i përket energjisë elektrike të gjeneruar, nëse ajo do të shitet në tregun e brendshëm apo do të eksportohet, do të varet nga “operatori i sistemit të transmisionit. Ne do t’ia shesim energjinë një kompanie në pronësi të Qeverisë, e cila do të vendosë se ku do të shitet ajo energji.”

Pra ky do të jetë dizajni i tregut. Transaksionet mes “Kosovës së Re” në pronësi private dhe KEDS po ashtu në pronësi private, do të ndërmjetësohen nga KOST në pronësi publike.

PYETJE PARLAMENTARE

Z. Ministër a mund të na tregoni se kush e mbulon dallimin në mes të çmimit të shitjes së MWh nga “Kosova e Re” dhe çmimit të blerjes nga KEDS?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

| | | | |
|---|--|--------------------------------|-------------------|
| PËR / ZA / TO | Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës z. Isa Mustafa | DATE DATUM DATE | 21.07.2015 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Puhie Demaku, deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! <i>Demaku</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë) | | |


Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA:

Është bërë pothuajse e zakonshme që Ministrat e kabinetit tuaj të mos ndejnë përgjegjësi ndaj organit më të lartë shtetëror, Kuvendit të Republikës së Kosovës. Përveç mospjesëmarrjes në seanca plenare, shumë prej tyre i shmangen raportimeve në komisione parlamentare.

PYETJE PARLAMENTARE:

A konsideroni ju si Kryeministër i vendit se duhet të zhvilloni instrumente të disiplinimit të vartësve tuaj në këtë drejtim?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|---|--|--------------------------------|------------|
| PËR / ZA / TO | <i>z. Hashim Thaçi,</i> zv. Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme | DATE DATUM DATE | 21.07.2015 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Puhie Demaku, deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJES <i>Demaku</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Nenit 45 paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, parashtroj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës:

ÇËSHTJA:

Ditë më parë, në një shkrim të shpërndarë në media, z. Robert Cooper deklaroi publikisht se element kyç i filozofisë mbi të cilën u mbështetën bisedimet Kosovë-Serbi ishte detyra për të mos e ndryshuar realitetin, por për ta vënë atë nën sundim të ligjit. Ai shkroi: "Ne nuk donim ta ndryshonim mënyrën se si jetonin serbët në Kosovë."

Pra, për herë të parë u tha publikisht se bisedimet ishin për çështje të brendshme të Kosovës dhe për legalizimin e situatës tashmë të vendosur de facto nga strukturat ilegale në veri të vendit dhe jo vetëm.

Ju këtë çështje ia keni fshehur gjithmonë publikut, madje keni thënë se kjo është rruga drejtë njohjes së shtetësisë. Për më tepër ju keni shkuar aq larg sa keni thënë se "me këtë marrëveshje Serbia e njohu shtetësinë e Kosovës."

PYETJA PARLAMENTARE:

z. Zëvendës Kryeministër, a ishte ky edhe qëllimi juaj në këtë dialog?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

05/1156/10-674

21.7.2015

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtrasa-Kancelarija za Predloge i Predstavka-Table Office

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 05/1156/10-674
Nr. i fletëve: 1
Data Datum Date: 21.7.2015
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

| | | | |
|---|--|--------------------------------|------------|
| PËR / ZA / TO | <i>Ministrin e Punëve të Brendshme z. Skendër Hyseni</i> | DATE DATUM DATE | 21.07.2015 |
| NGA / OD / FROM | <i>Deputetja: Ganimete Musliu</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | <i>Pyetje për përgjigje me gojë</i> | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


Çështja:

Si pasoj e aksidenteve në trafik çdo ditë në Kosovë raportohet për të vdekur e të lënduar dhe kjo gjendje është shqetësuese:

PYETJE :

I nderuari z.Ministër:

Ku e shihni problemin e këtyre aksidenteve dhe a keni menduar të merreni ndonjë aktivitet për parandalimin ose zvogëlimin e këtyre rasteve, qoftë në departamentin e patentë shoferëve, qoftë tek policia e trafikut??



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|---|--|--------------------------------|------------|
| PËR / ZA / TO | <i>Ministrin e Punëve të Brendshme z. Skender Hyseni</i> | DATË DATUM DATE | 22.07.2015 |
| NGA / OD / FROM | <i>Deputetja: Ganimete Musliu</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | <i>Pyetje për përgjigje me gojë</i> | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


Çështja:

Ndërtimi I objektit/ndërtesës për Policinë në Stacionin Policor të Drejtorisë Rajonale të Gjilanit, sipas informatave, ka filluar të ndërtohet që nga viti 2008. Ishte planifikuar të përfundonte për pesëmbëdhjetë(15) muaj. Ky objekt edhe sot e kësaj dite rezulton I papërfunduar ndërsa policia në Gjilan punon në kushte shumë të rënda dhe të pafavorshme.

PYETJE :

I nderuar ministër,

A mund të na tregoni neve dhe policisë së Gjilanit se pse ka ngecur ky projekt dhe kur pritet të përfundoj?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|---|--|--------------------------------|---------------|
| PËR / ZA / TO | Ministrin e Shëndetësisë z. Imet Rrahmani | DATE DATUM DATE | 25 korrik2015 |
| NGA / OD / FROM | Deputetja: Xhevahire IZMAKU <i>Xhevahire Izma</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Vitet e fundit ne Kosove ka një perceptim se është shtuar numri i femrave me diagnozën e kancerit ne mitër dhe qafe te mitrës !
Këto dite unë mora një informacion të rëndësishëm, (për mua qe s'jam pjese e kësaj fushe novacion dhe i rëndësishëm) pra,

Një përvoje gjermane dhe norvegjeze, ku vajzat e reja ne adoleshencën e pare, realisht ende pa hyre ne aktivitetin e marrëdhënieve seksuale, marrin vaksina, te cilat janë preventive për jetën e tyre ne te ardhmen ndaj rrezikut te kancerit ne mitër!
(Norvegjia e paska si aktivitet te planifikuar, d.m.th nxënëset i marrin vaksinat ne tri pjese ne një periudhe njëvjeçare gjate procesit mësimore,) ndërsa Gjermania vetëm me initiative vullnetare) !

I nderuar ministër;

Pyetja ime është kjo;

A ka një mundësi, qe edhe shteti ynë te pajiset me këtë vaksine, dhe a është kjo mundësi financiare e shtetit tone, sepse është shqetësuese fakti qe ne flasim shume për shërimin edhe ndihmat për gratë, qe preken me këtë sëmundje ne vendin tone, por pak dimë, se paku popullata, për parandalimin afatgjate, nëse është e mundur shkencërisht ne këtë kohe !

Unë ju falënderojë për përgjigjën dhe konsideratën ne çështje !



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|---|--|--------------------------------|------------|
| PËR / ZA / TO | Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi | DATE DATUM DATE | 28.07.2015 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Albulena Haxhiu, deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE! Kuvendi i Republikës së Kosovës <i>Alexis</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja

"Më datë 18 qershor në Kuvendin e Republikës së Kosovës u votua raporti me rekomandime që doli pas monitorimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.
Të paktën 7 nga rekomandimet e atij raporti bien në fushveprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë"

Pyetje parlamentare:

A ka filluar Ministria e Drejtësisë të ndermarë ndonjë veprim për zbatimin e atyre rekomandimeve? Nëse po çfarë saktësisht?